


PERMBLEDHJE JOTEKNIKE PER AKTIVITETIN:

**“IMPIANT PRODHIM BETONI DHE IMPIANT
FRAKSIONIMI”**

Vendodhja: Rruga nacionale Bajram Curri-Fierze, ZK 1301, Nr.
pasurie 262/14, fshati Bujan, Njesia Administrative Bujan,
Bashkia Tropoje.

Kërkues: Subjekti: “Shaban Mulosmani” Person Fizik



Janar, 2023

1 HYRJE

1.1 Te pergjithshme

Qellimi i ketij aktiviteti eshte funksionimi i impiant per prodhim betoni dhe impiantit te fraksionimit nga Subjekti "Shaban Mulosmani" Person Fizik. Aktiviteti zhvillohet ne krahe te rruges nacionale Bajram Curri-Fierze, ZK 1301, Nr. pasurie 262/14, fshati Bujan, Njesia Administrative Bujan, Bashkia Tropoje.

Subjekti "Shaban Mulosmani" Person Fizik me administrator Z. Shaban Mulosmani, do te ushtroj aktivitetin ne industrine e prodhimit te materialeve te ndertimit etj.

Subjekti per zhvillimin e aktivitetit te tij ka ndritur gjithë infrastrukturën e nevojshme.

Subjekti "Shaban Mulosmani" Person Fizik merret me veprimtari qe konsistojnë ne fushën e prodhimit te inerteve dhe prodhimit te betonit.

Nenshkrimi i nje sere konventash dhe miratimi i kuadrit ligjor per mjedisin ne funksion te tyre, detyron institucionet shteterore dhe subjektet fizike e juridike ti nenshtrohen disa procedurave vleresimi te impaktit te tyre para ndertimit dhe venies ne funksion te aktivitetit.

Raporti i permbkledhjes jo-teknike eshte nje prej instrumentave parandalues dhe minimizues te ndikimit mjedisor dhe per projektin specifik, hartohet duke u bazuar ne kerkesat e zhvillimit te aktivitetit nga subjekti "Shaban Mulosmani" Person Fizik.

Ky raport perfshin vleresimin, identifikimin, si dhe percaktimin e masave zbutese te ndikimit ne mjedis te aktivitetit te impiantit te prodhimit te betonit.

1.2 Procesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e zhvillimit te aktivitetit. Në procesin studimor të VNM përdoret informacioni dhe të dhënat teknike ekzistuese.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis hartohet qe ne fazen e projektidese per zhvillimin e aktivitetit, por gjithsesi, edhe per aktivite ekzistuese te cilat jane objekt i nje leje mjedisore ose i ligjit per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis. Sipas kushtetutes se Republikes se Shqiperise, shteti siguron me te gjitha mjetet dhe mundesite qe ka, nje mjedis te paster dhe te sigurte per qytetaret dhe brezat e ardhshem.

1.3 Kërkesat e përgjithshme për vlerësimin e ndikimit në mjedis të një projekti

Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit.

Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përgatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë, dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj. Vlerësimi përfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente.

Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, të ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit.

2 PERSHKRIMI I RAJONIT KU ZHVILLOHET AKTIVITETIT

2.1 Pozita gjeografike

Bajram Curri është territor në veri të Shqipërisë. Ai është pjesë e Rrethit të Tropojës. Si njësi administrative ajo përfshihet në garkun e Kukësit. Qyteti i Bajram Currit është qendra më e rëndësishme administrative dhe funksionale e 1Tetit të Tropojës. Qyteti nëthohet nga disa fshatra të komunes Margegaj. Në veri ai kufizohet me fshatin Margegaj, në lindje me fshatin Paqe, në jug dhe perëndim me fshatin Fushe-Lumi. Ndërsa si komuna fqinje në veri kufizohet me komunën Margegaj, në verilindje me komunën Tropojë, në jug me komunën Llugaj dhe Bujan. Qyteti i Bajram Currit ka një sipërfaqe prej 165ha, në të cilën jetojnë 8500 banorë. Dendësia mesatare e popullsisë është 27b/km².

Zona e njohura është lugina e Valbonës dhe zona e Alpeve. Qyteti i Bajram Currit është qendra kryesore administrative e Tropojës, ku është për qendruar numri më i madh i popullsisë, në krahasim me komunat përreth si dhe ka një zhvillim social-ekonomik të bazuar në sektorin e shërbimeve.

Vecorite litologjike

Gjeologjikisht rrethi i Tropojës, ku është pjesë dhe qyteti i Bajram Curri, shtrihet në kontaktin e përplasjeve të 3 zonave tektonike: të zonës së Mirditës, të zonës së Alpeve dhe të zonës së Cukllit dhe më thellë në madhe tektonike Shkoder-Peje.

Fonnacionet gjeologjike qe ndertojne truallin e kesaj zone jane te larmishme dhe te shumellojshme si sedimentare, magmatike, metamorfike te llojeve te ndryshme, me te cilat lidhen pasurite e shumta minerale nentokesore te cilat ndihmojne sadopak ne zhvillimin social -ekonomik te te gjithë rrethit. Me shkembinjte magmatike te cilet perfaqesohen nga peridotide qe kane ngjyre jeshile lidhet me mineralin e kromit. Te dy llojet e shkembinjteve favorizojne qe nethi i Tropojes te zhvilloje industrine e nxjenes se mineraleve te kromit. Shkembinjte magnetik dhe gelqerore janë me te përhapurit ne te gjithë territorin e bashkisë.

Vecori te morfologjike

Qyteti i Bajram Currit shtrihet ne gropen e Tropojes, e cila eshte grope me shtri1je me te madhe ne veri te Shqiperise. Ajo ka nje relief relativisht te bute dhe lartesi qe variojne nga 200-700-800 m mbi nivelin e detit. Fonnimi i kesaj grope lidhet me perplasjen e tri zonave tektonike (Mirdite,Alpe dhe Cukal) dhe me thye1jen e madhe tektonike Shkoder-Peje. Ajo perben nje graben te ri, i cili per nje kohe te gjate ka qene i zene nga nje liqen, prania e te cilit deshmohet nga qymyret dhe depozitimet argjilore. Ne kete liqen derdhej edhe Valbona me deget e saj. Pjesa me e madhe e liqenit eshte ne Cernice, ku edhe trashesia e argjilit eshte me e madhe. Tha1ja e liqenit lidhet me erozionin regresiv te ndonje dege te Drinit, qe pasi thau liqenin, terhoqi me vete njedhjet ujore duke formuar keshtu njedhjen ujore te lumit te Valbones. Ne kete proces kane ndikuar edhe levizjet ngritese, qe vazhdojne edhe sot.Per pasoje Valbona dhe deget e saj kane coptuar siperfaqen e kesaj grope. Levizjet ngritese jane zhvilluar te nderthurura me periudha qetesie relative, qe eshte shoqeruar me fmmimin e 2-3 nivele taracash erozive-akumuluese qe ne dalje te Valbones dhe Gashit ne gropen e Tropojes, nderthuren me kodrinat moranike. Copetitni horizontal i relievit te saj eshte i madh sidomos ne shpatin perendimor. Vlerat me te vogla takohen ne siperfaqet e pakta te sheshta te kesaj grope. Energjia e relievit merr vlera qe lekunden nga 50-100 m/km2 ne pjesen fundore, ne mbi 300 m/km2 ne pjesen veriore te saj. Grope e Tropojes eshte asimetrike:shpati perendimor i perbere nga flishi ne pjesen e poshtme, eshte me i latte dhe me i copetuar se ai lindor, verior dhe jugor shume te thepisuara kryesisht gelqerore.Qyteti i Bajram Currit ITethohet nga maja e

kreshta te larta dhe lugina te thella lumore. Ketu mund te permendim kmTizin Toplane-Bosh dhe maja e Hekurave ne pjesen perendimore, lugina e Nikaj-Currajt ne lmtesi nga 140 m deri ne 1200-1300 m, lugina e Valbones ne veri,etj.


Vecorite e klimes

Bajram Curri ben pjese ne zonen klimatike mesdhetare paramalore dhe malore me ndikim kontinental. Klima karakterizohet nga nje dimer i ftohte dhe vere e fresket dhe e thate. Kjo lidhet me ndikimin e fuqishem te ererave te forta qe vijne nepeimjet qafes se Morines dhe te Pejes nga Rrafshi i Dukagjinit. Temperatura mesatare e janarit anin ne neth 1 °C, ndersa ajo e korrikut ne 22°C. Temperatura mesatare vjetore eshte rreth 11.9°C, ndersa temperatura minimale e regjistruar deri tani eshte -22°C. Reshjet bien ne forme shiu dhe ne forme bore. Reshjet jane te shperndara ne menyre te rregullt, ku bien rreth 1450mm/vit. Sasia e reshjeve mesatare arrin ne 1700mm. Ato ne forme bore ne disa zona te ve9anta shkojne deri ne 2-3m si rasti i vitit 1985. Bora zgjat nga fund i vjeshtes ne interval deri nga fillimi i

pranveres. Po fi analizojme keto elemente klimatike del se kjo shumellojshmeri klimash e favorizon zhvillimin social-ekonomik te zones.

Temperat1uat maksimale te ajrit ne grade celcius ne qytetin e Bajram Currit sipas muajve.

| Muaji | janar | shkurt | mars | prill | maj | Qeshor | korrik | gusht | shtator | tetor | nëntor | dhjetor | vjetore |
|---------|-------|--------|------|-------|------|--------|--------|-------|---------|-------|--------|---------|---------|
| B.Curri | 0,3 | 2,4 | 6,1 | 11,8 | 16,1 | 20 | 22,2 | 22,4 | 18,2 | 12,4 | 7,8 | 3,1 | 11,8 |



Temperat minimale te ajrit ne grade celcius ne qytetin e Bajram Currit sipas muajve

| Muaji | J | Sh | M | P | M | Q | K | G | SH | T | N | DH | V |
|---------|-------|-------|-------|------|-----|---|-----|-----|-----|------|-------|-------|-------|
| B.Curri | -18,7 | -17,9 | -13,0 | -2,8 | 0,3 | 4 | 6,9 | 6,4 | 3,3 | -2,0 | -14,8 | -16,4 | -18,7 |

Vecorite hidrografike

Qyteti i Bajram Currit ben pjese ne pellgun ujembledhes te Valbones, i cili eshte lumi me i gjate i Alpeve shqiptare dhe ushqimi kiyesor i saj eshte shkritja e bores. Pavaresisht se lumi i Valbones nuk kalon ne tell'itorin administrativ te qytetit te Bajram Currit ate e pershkojne 3 deget e tij te rendesishme qe jane: perroi i Shudenices, perroi i Janes si dhe nje degezim i Janes si dhe nje degezim i Shudenices. Gjithashtu jane te pranishme dhe disa burime ujore siperfaqesore, te cilat sherbejne dhe per fumizimin me uje te pijshem ashtu dhe per vaditje ne disa zona ne periferi te qytetit

Vecorite e tokave

Persa i perket llojit te tokave ato jane te shumellojshme te kafejta dhe te hirta kafe si dhe te murrme pyjore dhe aluvionale me ne veri te qytetit, te cilat i perkasin lugines se Valbones. Ne tokat e kafenjta kultivohen bimet e arave, drufutoret, perimet, te cilat shtrihen ne pjesen periferike te qytetit. Shkalla e degradimit ne zona te ve9anta paraqitet e lmte sepse u hapen toka ne pje1Tesi deri ne 10°, gje qe

shkakton degradim të tokës së shkaktuar nga faktori antropogjen dhe më pas nga ai natyror. Pjesa më e madhe e sipërfaqes është e zënë nga ndëtimet dhe vetëm në pjesën periferike vihen re kultivimi i kulturave drufutrore ashtu dhe të tokave bujqesore.

Vecoritë e biodiversitetit

Diferencimet e mëdha mbi nivelin e detit, në mes të zonës fushore 250m më asaj malore mbi 2000m, majave shumë të larta, luginave shumë të thella, ekspozimit të shpateve ndaj nezatimit diellor, përbejes së shkëmbinjve, burimeve të shumta ujore dhe mikroklimave që krijohen krijojnë kushte ideale për shumëllojshmëri të specieve bimore. Për vlerat e larta që ka biodiversiteti një përqindje e konsiderueshme e specieve bimore janë bime endemike. Qyteti i Bajram Currit ndodhet në brezin e pyllit të lisit. Në pjesën veriore të qytetit ndodhet "Pylli i Geshtenjës" me një sipërfaqe 2600 ha. Janë të pranishme kati i dushqevë dhe pjesërisht i ahut me në periferi. Një e vecantë për këto zone është se një pjesë e banorëve që jetojnë në qytet, bëjnë një jetë të dyfishtë në mes dy boteve: ajo nga qershori në shtator dalin në bjeshkë për mbledhjen e bimeve mjekësore që sigurojnë një pjesë të të ardhurave dhe pjesa tjetër në zonën fushore (qytet) në periudhën shtator-maj. Fauna përfaqësohet nga disa lloje kafshësh dhe shpendësh të eger që jetojnë në brendësi të pyllit dhe të masiveve të geshtenjave në periferi të zonës së qytetit.

Vlerësimi i kushteve natyrore (resurseve natyrore). Pozita gjeografike si dhe kushtet natyrore në të cilat ndodhet qyteti i Bajram Cuni ofrojnë kushte të mira të zhvillimit social dhe ekonomik të zonës. Kushtet natyrore në të cilat ndodhet qyteti, vendosja në një reliev relativisht të nufshët, me një ldimë me të zbutur në krahasim me komunat e tjera përreth, njëti i pasur hidrik si dhe puna e tokave të kafenjta dhe të hirta kafe, ofrojnë mundësi zhvillimi të sektoreve të shërbimeve ashtu dhe të sektorit të bujqësisë në zonën periferike të qytetit. Gjithashtu prania e një sipërfaqe të konsiderueshme të pyllit të geshtenjës ofron mundësi të gjenerimit të të ardhurave nëpërmjet tregtimit.

3 PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

3.1 Qellimi i aktivitetit

Qellimi i ketij aktiviteti eshte vazhdimi i funksionimit te prodhimit te betonit dhe fraksionimit te naterilave ndertimore nga Subjekti "Shaban Mulosmani" Person Fizik. Aktiviteti ekzistues zhvillohet ne krahe majte te rruges nacionale Bajram Curri-Fierze, ZK 1301, Nr. pasurie 262/14, fshati Bujan, Njesia Administrative Bujan, Bashkia Tropoje.

Subjekti investitor

Subjekti zhvillues i keti aktiviteti eshte subjekti "Shaban Mulosmani" Person Fizik me nuis L49706601N dhe me seli ne Kukes, Bujan, BUJAN, Truall, Zone kadastrale 1301,Nr pasurie 262/14. me administrator Z. Shaban Mulosmani.

Vendodhja e aktivitetit

Ky aktivitet ndodhet ne krahe te rruges nacionale Bajram Curri-Fierze, Bajram Curri-Fierze, ZK 1301, Nr. pasurie 262/14, fshati Bujan, Njesia Administrative Bujan, Bashkia Tropoje. Siperfaqe e sheshit ne dispozicion te marre me qerra nga subjekti "Shaban Mulosmani" Person Fizik eshte **2816 m²**.

Sheshi ne dispozicion te impjantit identifkohet sipas ortofotove te meposhtme:



Ortofoto e zones ne Vleresim

Sheshi ku eshte instaluar impianti eshte i niveluar dhe si bazament per linjen teknologjike sherbejne pilotat te nguluara ne toke, ku dhe eshte montuar linja e teknologjike, pjesa ku eshte ndertuar kulla e vrojtimit dhe paneli i kontrollit eshte e shtuar me beton, gjithashtu eshte ndertuar nje mure mbajtes

prej betoni i cili shërben për shkarkimin e lëndës së parë që vjen nga subjektet e licencuara, pjesa tjetër e sheshit ku zhvillohet veprimtaria është e shtuar me çakull dhe e niveluar, gjithashtu është ndërtuar rrjeti i drenazhimit të ujërave të shiut dhe ujërave teknologjike të gjeneruara nga vetë impianti.

Objekti ka një sipërfaqe relativisht të mjaftueshme të përbërë nga impianti dhe hapësirat e nevojshme për këto aktivitete duke shfrytëzuar të gjitha ambientet për këto aktivitete. Sipërfaqja ku është instaluar impianti i prodhimit të betonit dhe impianti i fraksionimit është 2816 m² dhe është në menaxhim të subjektit.



Hartë topografike e zonës në vlerësim

4.1 Të dhëna teknike të aktivitetit


Elementet kryesore të impiantit të betonit.


1. Bunkeri i magazinimit të agregateve
2. Bunkeri i peshimit të agregatit
3. Rripi i transportuesit nxjerrës
4. Rripi transportues
5. Kabina e kontrollit
6. Bunkeri i mbajtjes së agregateve
7. Bunkeri i mbajtjes së cimentos
8. Bunkeri i peshimit të ujit

9. Transportues me vidë të çimentos
10. Sillos I magazinimit te cimentos
11. Struktura mbajtese e sillosit
12. Mishelatori
13. Koni I shkarkimit
14. Përzierësi i binjakëzuar

Sekuena e operacioneve për një cikël prodhimi eshte :

- Kontrollohet që njësia e ujit të jetë nën presion.
- Fuqizimi i panelit elektrik dhe aktivizimi i qarkut të kontrollit.
- Komisionimi i kompresorit (impiantit përzierës) dhe pritje që të gjitha qarqet pneumatike të jenë nën presion.
- Doza e inerteve.
- Dozimin e çimentos.
- Futja 10-15% të ujit në mikserin e kamionit.
- Shkarkimi i agregateve në mikserin e kamionit.
- Shkarkimi i betonit në përzierësin e çimentos.
- Mbyllni dozimin e ujit.





Si Prodhetet Betoni

Betoni eshte nje mase e perbere nga material inerte te thata (rere, granil) dhe nga cemento aditive te ndryshme qe ndihmojne procesin e tharjes e te ngrirjes se betonit .

Kjo perberje eshte nje material natyror dhe i riciklueshme dhe eshte i perdorshem ne nje game te gjere ne fushen e ndertimit, mund te perdoret ne bordurat e rrugeve, pistave te ndryshme, shesheve dhe fushave sportive, vepra arti te ndryshme si ura, mbikalime dhe nenkalime, kolona mbajtese, ndertesa banimi dhe sherbimi etj.

Betoni prodhetet ne kete menyre: ne sillosat e furnizimit me lende te pare me inerte, hidhet rere dhe granil i permasave te ndryshme , sipas cilesise te kerkuar te betonit. Nga ketu, inertet kalojne ne mikser nepermjet transportierve te cilet punojne me energji elektrike. Ne mikser, pasi perzierja e tyre, shtohet dhe cimeto e lenget per te krijuar cilesin dhe vetite e kerkuara te betonit. Kryhet miksimi dhe pezjerja e elementeve perberes dhe pastaj kalon menjehere ne sillosen e ngarkimit te kamioneve qe do te kryejne transportin e betonit ne vendin e perdorimit, ne kantierin e ndertimit.

Impianti njeje betoni eshte montuar ne fund te sheshit te prones ne nje distance prej 250 m large autostrades, prane fshatit Kashar, Tirane. Ne kete shesh do te depozitohen materialet e nevojshme inerte. Ne kete objekt projektimi i zonave te parkimit eshte mbi toke. Sistemi i mbrojtjes nga zjarri eshte i ndertuar pasi kantieri funksionon me objekte kapanone.

Materialet inerte qe do te perdoren per prodhimin e betonit sipas klasave te ndryshme jane te cilesise se larte dhe konform kushteve te cilesise per keto produkte. Inerti qe perdoret eshte i lare dhe sigurohet nga karriera prane zones.

Nyja ka sillosa me kapacitet te pershtateshem, te magazinuar dhe te pajisura me peshore elektronike, si dhe sisitem tubacionesh, valvula, filtrash qe realizojne nje hedhje te dozes ne autobetone pa krijuar ndotje ne ajer nga pluhurat dhe pse niveli i ndotjes eshte minimal pasi inertet jane te lara.

Sistemi i drejtimit te impiantit ndodhet ne nje kabine e cila eshte e gjitha elektronike me parametra bashkekohore. Impianti ka nje kapacitet prodhimi prej **80-100 m³ / ore**.

Raporti per te prodhuar beton eshte 1(C):2(R):4(Z-Ca) ndersa uje eshte raporti $u/\zeta=0.6$, pra per kete impiant ne baze te kapacitetit mesatar eshte **90 m³/h**, arrijme ne perfundimin se ketij impianti do ti duhen te pakten **36 t cemento ,72 t rere ,144 t cakell apo zall , ndersa uje 21.6 m³/h**.

Ne lidhje me ngarkimin dhe transportin eshte parashikuar qe pajisjet do te perbehen nga makina ngarkuese, kamion vetshkarkues, etj. Kjo zgjidhje behet per shkak te adaptueshmerise dhe fleksibilitetit te larte qe kane keto lloj pajisjesh, shkalles se larte te disponueshmerise, si dhe mundesine per te kombinuar ato per te realizuar punime te ndryshme sipas nevojave te prodhimit. Nevojat per ngarkim percaktohen nga numri i kamioneve te nevojshem qe varen nga distanca e transportimit, disponueshmeria per pune e makinave ngarkuese dhe e kamioneve, oret e punes ne dispozicion per dite/turn, etj. Koeficienti i mbushjes se koves se makines ngarkuese zakonisht eshte 80%.



Mjet transportues i betonit.



Mjet transportues i materialeve inerte

Raporti per te prodhuar beton eshte 1(C):2(R):4(Z-Ca) ndersa uje eshte raporti $u/\zeta=0.6$ pra per nje kapacitet mesatar **prej 90 m³/h**, arrijme ne perfundimin se ketij impianti do ti duhen rreth **36 t cimento ,72 t rere ,144 t cakell apo zall , ndersa uje 21.6 m³/h.**

Ne lidhje me ngarkimin dhe transportin eshte parashikuar qe pajisjet do te perbehen nga makina ngarkuese, kamion vetshkarkues etj. Kjo zgjidhje behet per shkak te adaptueshmerise dhe fleksibilitetit te larte qe kane keto lloj pajisje, shkalles se larte te disponueshmerise, si dhe mundesine per ti kombinuar ato per te realizuar punime te ndryshme sipas nevojave te prodhimit.

Nevojat per ngarkim percaktohen nga numri i kamionve te nevojshem qe varen nga distanca e transportimit, disponueshmeria per pune e makinave ngarkuese dhe e kamionve, oret e punes ne dispozicion per dite/turn, etj.

Lloji i impjantit eshte i tille qe komandohet nepermjet njesise qendore, ku behet edhe programimi i sasise se lendeve te para qe do te marri ne perqindje te caktuar, per prodhimin e betonit. Impjanti eshte i lidhur me depoziten e ujit, me depoziten e solventeve, reren e cila merret ne menyre automatike nepermjet hinkave ku qendron lenda e pare dhe hidhet ne kazanin e perzjerjes.

Impianti i fraksionimit te materileve ndertimore

- Pedane e Furnizimit
- Bunker, Ushqyes
- Frontoje, Gurethyes me nofulla
- Transportier kryesor
- Site Vibruese me 2 Kate
- Transportier Kryesor

- Site Vibruese me 3 kate
- Frontoje,
- Mulliri Sekondar
- o Transportier i produktit te mullirit
- o Transportier Granili Nr. 1 ,
- o Transportier Granili Nr. 2,
- o Transportier i Reres se gurit 0-5
- o Pulti i Komandimit

Pedane e Furnizimit me lende te pare

Pedana sherben per mbushjen e Bunkerit Ushqyes me lende te pare (inerte). Pedana eshte projektuar me mure mbajtese prej betoni, eshte mbushur me materiale inerte dhe eshte vendi ku makinat e shkarkimit kolojne me qellim furnizimin e impiantit me lende te pare. Lartesia e pedanes eshte 4 m mbi nivelin e tokes dhe ka nje pjerrresi prej 35 o e cila ndihmon ne ngjitjen dhe zbritjen e mjeteve te transportit. Vete impianti i fraksionimit eshte projektuar i tille qe te ndihmoje dhe te jete sa me eficient ne fraksionimin e mineralit. Ai vjen ne formen e shkalleve, ku pika me e larte eshte ajo e bunkerit ushqyes.

Bunker Ushqyes

Bunkerit ushqyes mund te quhet dhe hapi i pare qe ndodh ne procesin e furnizimit te impiantit me lende te pare. Ky bunker ka nje kapacitet prej 60 m³ dhe eshte i mjaftueshem per furnizimin e impiantit me lende te pare per 1 ore. Bunkerit furnizohet here pas here me lende te pare nepermjet pedanes se furnizimit, ku mjetet shkarkojne lende e pare te destinuar per fraksionim. Bunkerit ushqyes lidhet me pjesn tjetere te impiantit nepermjet transportierit kryesor. Bunkerit ka formen e nje hinke ne fund, e cila nepermjet vibrimeve te lehta dhe transportierit me rrula furnizon frontojen, gurethyesin me nofulla.

Mulliri Primar

Mulliri primar eshte i instaluar ne vazhdimesi te bunkerit ushqyes. Inertet me madhesi kokrrize me te madhe, nepermjet forces se rendeses dhe me gravitet kalojne ne mullirin primar i cili ben procesin e thyerjes dhe seleksionimit te gurit gelqeror, sipas kerkesave te tregut konsumator. Ky process teknologjik realizohet me qellim rritjen e rendimentit te instalimit dhe permbushjen sa me efektive te kerkesave te produktit perfundimtar.

Site vibruese

Sita vibruese furnizohet nga bunkerit ushqyes nepermjet transportieri kryesore me rrula, lenda e pare kalon ne siten vibruese, Lenda e pare fillimisht kalon ne katin e pare te sites, ku kryhet procesi i ndarjes se sterileve sipas granulometrise se tyre (madhesia e kokrrizes). Prosesi kryesor i sites eshte ndarja e reres natyrale nga permbajtja qe ka lenda e pare. Ne katin e dyte te sites vibruese depozitohet rera natyrale e papaster, e cila ne permbajtje te saj ka edhe % te dheut, ashtu sikurse ka ardhur. Pastaj lendet e para te ndara sipas granulometrise perkatese kalojne ne proceset e tjera te impiantit.

Frontoje, Gurethyesi me Nofulla

Pas procesit te sites vibruese me dy kate, lenda e pare me madhesi kokrrize me te madhe kalon ne gurethyesin me nofulla. Madhesia e kokrrizave varion ne varesi te lendes se pare. Qellimi i kesaj makinerie eshte thyerja e kokrrizave me madhesi me te madhe dhe perftimin e kokrrizave me diameter me te vogel. Procesi qe ndodh eshte ai i therrmimit te gurit gelqeror nepermjet nofullave, duke e bluar ate ne kokrriza me te vogla dhe dergimin e tyre nepermjet transportierit me gjatesi 3 metra linear me qellim qe ti nenshtrohet proceseve te tjera.

Mulliri Sekondar

Mulliri Sekondar eshte i instaluar ne vazhdimesi te impiantit te fraksionimit. Nepermjet ketij procesi perftohet produkti i Granilit Nr.2. Sasia e produktit i cili nuk arrin te fraksionohet sipas kerkeses kalon edhe nje here ne procesin e sites vibruese nepermjet transportierit te mullirit sekondar dhe transportierit kryesor nr.2. Ky proces teknologjik realizohet me qellim rritjen e rendimentit te instalimit dhe permbushjen sa me efektive te kerkesave te produktit perfundimtar.

Frontoje, Gurethyesi me Nofulla

Pas procesit te mullirit sekondar, lenda e pare me madhesi kokrrize me te madhe perfundon ne gurethyesin me nofulla. Madhesia e kokrrizave varion ne varesi te lendes se pare. Qellimi i kesaj makinerie eshte thyerja e kokrrizave me madhesi me te madhe dhe perftimin e kokrrizave me diameter me te vogel. Procesi qe ndodh eshte ai i therrmimit, duke e bluar ate ne kokrriza me te vogla dhe dergimin e tyre nepermjet siten vibruese me 3 kate

Site vibruese

Sita vibruese, ben te mundur ndarjen ne tre produkte kryesore, duke ju afruar fazes perfundimtare te produktit perfundimtar. Vibrimet e lehta qe i behen lendes se fraksionuar deri ne kete proces, ben te mundur ndarjen e saj ne tre paraprodukte:

- Granil 1
- Granil 2
- Rere e thyer

Transportier i reres se thyer

Transportieri i reres se thyer transporton produktin e reres se thyer, e cila depozitohet ne sheshin e instalimit.

Rera e thyer

Rera e thyer eshte nje nga produktet e gatshme qe perftohen nga impianti i fraksionimit te gurit gelqeror. Ky produkt depozitohet ne sheshin e instalimit dhe eshte i gatshem per te plotesuar kerkesat e tregut konsumator.

Transportier Granil Nr.1

Transportieri i Granilit Nr.1 sherben per transportin e produktit perfundimtar te perftuar.

Transportier Granil Nr. 2,

Transportieri i Granilit Nr.2 sherben per transportin e produktit perfundimtar granil nr.2 per te sheshi depozitimit.

Pulti i Komandimit

Pulti i komandimit eshte pika me e larte e impiantit te fraksionimit. Nga kjo pike vihen re te gjitha instalimet, duke mbarvajtur dhe proceset fizike qe ndodhin ne impiant. Ne kete pike jane te instaluar te gjitha aparaturat automatike qe kontrollojne te gjitha proceset e impiantit te fraksionimit. I gjithe procesi eshte i automatizuar.

Pershkrim i pergjithshem

Impianti i fraksionimit funksionon mbi bazen e nje procesi te thjeshte fizik, i cili ben te mundur qe lenda e pare inerte, e cila sigurohet nga subjekte te licencuara dhe ka permasa te kokrrizave te medha, i nenshtrohet proceseve fizike si thyerja dhe bluarja, duke perftuar ne kete menyre produktin e deshruar per tregun rajonal.

Hapat qe ndiqen ne impiantin e fraksionimit te inerteve jane:


Pedane e Furnizimit → Bunker Ushqyes→ Mulliri primar→ Site Vibruese →Frontoje, gurethyesi me nofulla→ Mulliri sekondar→ Frontoje, Gurethyes me nofulla→ Site Vibruese → Transportier Granili Nr. 1, → Transportier Granili Nr. 2, → Transportier i produktit te reres se thyer → Pulti i Komandimit

Nga procesi i fraksionimit nuk gjenerohen mbetje, pasi i gjithe minerali i thyer fraksionohet sipas madhesise se grimces.

Te gjitha inertet qe futen ne proces , kur eshte e nevojshme (inerte qe kane permbajtje dherash te kuq, shtrese vegjetale) kryhet edhe larja ne lavatricen e inerteve per te larguar dherat. Pas procesit te larjes inertet kalojne ne impiantin e fraksionimit. Uji i perdorur per kete proces qendron ne vasken e lavatrices ku kryhet procesi i dekantimi te dherave/shtrese vegjetale. Pas dekantimi uji perdoret ne impiantin e prodhimit te betonit, ndersa dherat perdoren si shtrese vegjetale ne bimesine rreth aktivitetit.

SKEMA TEKNOLOGJIKE

Kapaciteti 100 m³/ore



4 MASAT ZBUTESE TE NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Masat e pergjithshme te propozuara per zbutjen e ndikimeve negative mjedisore

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate procesit te thyerjes se gurit, si te pluhurit ne ajer, zhurmave, erozionet si dhe uljen e efekteve negative hapsinore ne territor, faun dhe flore.

☒ Parandalim

- Perzgjedhja e teknologjise me cikël të mbyllur me pajtueshmeri mjedisore
- Instalimi korrekt i makinave, sipas skemes teknologjike te permiresuar
- Perzgjedhja dhe trajnim i personelit per menyren e perdorimit te teknologjise dhe veprimet
- Siperfaqja e kantierit do te jete vazhdimisht e lagur per shmangien e ngritjes se pluhurit gjate aktivitetit;
- Kontroll i vazhdueshem dhe mirmbajtje e filtrave te kapjes se pluhurit dhe gazeve
- Sigurimi i sistemit te komandimit te pompave, filtrave dhe pastruesve te tjere;
- Zbatim i rigoroz i sigurimit teknik gjate punes dhe nderprerjes se saj
- Vezhgim dhe kualidim i vazhdueshem i te gjithë teknologjise se projektit, sistem i qarrkullimit te produktit, saracineska, tubo, valvola, tapa, guarnicione;
- Testimi periodik i teknologjise agregateve te saj.

Kontroll

- Sigurimi i te gjitha pajisje te nevojshme per riparim, pastrim dhe nderhyrje ne rast emergjencash
- Kompaktesim dhe lagje e inerteve ne qiell te hapur
- Lagje e sheshit te punes dhe rrugeve te levizjes se kamioneve ne kantier
- Levizje e ngadalte e automjeteve ne kantier dhe jashte tij
- Larje e shpeshte e makinerive dhe kamioneve te punes
- Transporti i inerteve me kamion te mbuluar mbulesë me Polietilieni
- Gjeneratori dhe pompa e karburantit duhet te rrethohet me mur dhe te kete nje vend te vecant

☒ Nderhyrje

- Riparim i menjehershëm i difekteve dhe avarive teknologjike
- Aktivizim i menjehershëm i stafit dhe mjeteve ne rast emetimesh dhe derdhjesh te pa parashikuara sipas skemes. - Pastrim i menjehershëm i derdhjeve aksidentale
- Njoftim i menjehershëm i autoriteteve dhe njesive te specializuara ne rast emergjencash (zjarrfikes, autoambulanca)

☒ Administrim

- Perdorimi dhe ruajtja me pergjegjesi i te gjithë infrastruktures dhe makinave sipas skemes dhe rregullave teknologjike.

☒ Pluhura te shkaktuara gjate fazes se transportit (aerosole)

Mjetet e transportit duhet te levizin te mbuluara gjate transportit te ngarkeses, mjetet duhet te pastrohen vazhdimisht nga balta para daljes se tyre nga kantieri .

Emetim gazesh nga automjetet

Sasia do te jete minimale por duhet te punohet me eficence dhe te ulet koha e mbajtjes ndezur pa gene nevoja e motoreve te mjeteve.

☒ Emetim zhurmash vibracioni dhe aromash

Duhet te kontrollohen vazhdimisht pajisjet dhe impiantet per zhurmen e shkaktuar. Edhe per kete ndikim duhet te shkurtohet ne maksimum koha e mbajtjes ndezur te motorave te mjeteve;

☒ Menaxhimi i mbetjeve ngurta

Administrata dhe punonjesit e kantierit do ti kushtojne vemendje te vecante edhe ketij aspekti per te parandaluar ndotjen ne mjedis nga dispersiteti i amabalazheve te cimentos etj. Ne mjediset e kantierit jane vendosur kazane te grumbullimit te mbetjeve te krijuara nga veprimtaria e kantierit. Mbetjet shoqeria do ti dergoje sipas nje marreveshje me njesine administrative te zones ne fjale ne pike grumbullimin e mbetjeve urbane te zones.

☒ Menaxhimi i mbetjeve te lengta

Mbetjet e lengeta jane ujrat qe shkarkohen nga larjet teknologjike te skemes. Uji qe derdhet nga ky perpunim presupozohet i paster dhe nuk shkakton ndotje te mjedisit. Ne perfundim te trajtimit uji shkarkohet ne tubacionet e ujerave te zeza te zones.

Programi i monitorimit dhe elementet e tij

Ne pergatitjen e programit te monitorimit specialistet kane marre ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis. Persa me siper eshte menduar qe te perzgjidhen per tu monitoruar nga laboratore te nenkontraktuar nga vete shoqeria ata elemente qe realisht mund te indentifikohen, maten, rregjistrohen dhe komunikohen ne organet e administrimit te mjedisit (DRM, Bashki etj). Te dhenat cilesore, sipas tabelës do te hidhen ne nje regjister qe administrohet nga vet kompania dhe do te dorezohen ne DRM e Qarkut sa here ju kerkohet, sipas proceduarve ligjore dhe rregulloreve.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

☒ Zbatimi i projektit nuk do te kete pasoja negative te mundshme ne mjedisin e zones.

☒ Procesi teknologjik i fraksionimit nuk shoqerohet me shkarkime të lëngta të rrezikshme. Ujerat që përdoren në linjën e fraksionimit thuajse nuk kanë teprica sepse dozohen ne sasi te percaktuara, sasite minimale shkarkohen vetem pas dekanitimit te mases se ngurte ne vasken dekantuese.

☒ Meqenëse lendet e para te përdorura për fraksionim jane gure gelqerore, ujerat nuk kanë elemente qe mund të kontaminojnë mjedisin ujor prites, sipërfaqësore, nentokësore apo tokën.

☒ Perreth perimetrit te objektit do te ndertohen kanalet drenazhues per ujerat atmosferike ne menyre qe te shmanget fenomeni i erozionit.

Ky aktivitet nuk perdore lende te rrezikshme per shendetin e punonjesve si dhe te popullsisë perreth zones dhe si rrjedhim nuk ndikon negativisht tek ata.

☒ Ky projekt nuk sjell emetime te gazeve ne atmosfere .

☒ Gjatë procesit të ngarkim – shkarkimit te materialit behet pluhur i lehte dhe drejtuesit e shoqerise do te marrin masa per sperkatjen me uje, për paisjen e punëtoreve dhe manovratorve te mjeteve te renda me mjetet e domosdoshme për mbrojtjen nga pluhuri, si kominoshe pune, kapele mbrojtese, doreza pune, maska për mbrojtjen nga pluhuri.

☒ Niveli i zhurmave qe vijne nga automjetet dhe pajisjet e tjera jane brenda normave te lejuara. Nuk perbejne problem shqetesues per punonjesit dhe as per banoret e zones perreth qe jane ne nje distance te konsiderueshme.

☒ Furnizimi me uje do te sigurohet nga nje pus qe ndodhet ne ambjentet ku do te ngrihet impianti

☒ Furnizimi me energji elektrike do te sigurohet nga rrjeti ekzistues qe mbulon zonen duke plotesuar te gjitha kushtet teknike.

☒ Zona ku do zbatohet projekti nuk njihet si zone e mbrojtuar me vlera arkitektonike dhe kulturore , pra nuk kemi ndryshime apo demtime te saj duke qene se nuk ekziton ne kete territor.

☒ Per nje pune sa me optimale në impiant zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe punetoret e manovratorët njihen me keto rregulla ne menyre periodike nga drejtuesit teknik te firmes.

Rekomandime

☒ Duke ditur se gjate proceseve te punes ne linje emetohen në mjedis pluhur i lehte, ka zhurma te makinerive për të rritur sigurinë në punë të punonjësve dhe per te ulur ne maksimum impaktin ne mjedis, duhet të:

☒ Te behet rregullisht monitorimi i gjendjes teknike te automjeteve

☒ Te behet monitorimi periodik i emetimit te zhurmave ne mjedis.

☒ Te behet monitorimi periodik i emetimit te pluhurit ne ajer.

☒ Te njihen punonjesit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik,

☒ Te pastrohen dhe mirembahen kanalet e drenazhimit te ujerave perreth perimetrit te

linjes

☒ Te menaxhohen mbetjet e ngurta ne bashkepunim me Njesine e Qeverisjes Vendore.

☒ Te sigurohet furnizim i mire me energji elektrike per te reduktuar ose shmangur oret e punes se gjeneratorit dhe nderprejre te procesit te punes.

☒ Te perdoret lende djegese e cilesise se pare per gjeneratorin dhe mjetet e transportit, ku niveli i sqfurit te jete brenda normes se lejuar prej 10ppm.

☒ Te aplikohet larja e shesheve te pa shtruara per te reduktuar pluhurin.

☒ Te mos depozitohet lende e pare ne sasi te medha, per te reduktuar demtimin e peizazhi dhe te erozionit te eres dhe te shiut.

☒ Te kryhet larja e automjeteve te transportit ne menyre periodike.

☒ Te vendosen kosha dhe postera sensibilizues per mbajtjen paster te ambjenteve